

OPINIONI I QYTETARËVE PËR POLICINË

**Rezultatet e anketës së opinionit publik në
Kosovë**

Shtator, 2017



OPINIONI I QYTETARËVE PËR POLICINË

Rezultatet e anketës së opinionit publik në Kosovë

BOTUES

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Rr. Sylejman Vokshi, B/2, Nr. 1, 10000,
Prishtinë
Tel: +381 38 221 420
E-mail: info@qkss.com
www.qkss.org
www.pointpulse.net

AUTOR

Plator Avdiu

REDAKTOR

Saša Djordjević

PËRKTHYER NË SHQIP NGA

Durim Tabaku

DIZAJN I PRELOM

DTP

Prishtinë, 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E GRAFIKËVE.....	4
PËR ANKETËN.....	5
PËRMBLEDHJE	6
BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONE	8
Policia është institucioni më i besueshëm në Kosovë	8
PERCEPTIMI PËR POLICINË.....	13
Perceptim pozitiv i publikut për policet dhe policët në Kosovë.....	13
Punësimi në polici ndikohet nga politika dhe nepotizmi.....	14
Policia e Kosovës i shërben më së shumti interesave të qytetarëve	15
Nivel i lartë i ndikimit të politikanëve në Policinë e Kosovës.....	17
PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN	19
Kuvendi i Kosovës është institucioni më i korruptuar më 2017.....	19
Policia e trafikut dhe policia kufitare janë më të prekurat nga korrupsioni	21
LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT	23
Shumica e qytetarëve janë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin policor.....	23
Stacioni lokal i policisë – adresa e parë ku qytetarët do të denonconin korrupsionin policor në Kosovë	24
Qeveria e Kosovës duhet të luftojë korrupsionin në polici	26
Nevoja për rritjen e rolit të OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit	27
METODOLOGJIA	29

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Besueshmëria në institucionet e Kosovës (2016 dhe 2017 - krahasim)	9
Grafiku 2: Besueshmëria në Policinë e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	10
Grafiku 3: Perspektiva gjinore në perceptimin për Policinë e Kosovës (2017)	10
Grafiku 4: Perceptimi në zonat urbane dhe rurale për Policinë e Kosovës (2017)	11
Grafiku 5: Perspektiva rajonale në perceptimin për Policinë e Kosovës (2017)	12
Grafiku 6: Perspektiva etnike në perceptimin për Policinë e Kosovës (2017)	12
Grafiku 7: Policja mesatare në Kosovë (2017)	13
Grafiku 8: Polici mesatar në Kosovë (2017)	14
Grafiku 9: Mënyrat e përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në Policinë e Kosovës (përgjigje të shumëfishta – krahasimet ndërmjet viteve 2015, 2016 dhe 2017)	15
Grafiku 10: Kapaciteti në të cilën Policia e Kosovës vepron më së shumti (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	16
Grafiku 11: Kapaciteti në të cilën Policia e Kosovës vepron më së paku (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	17
Grafiku 12: Ndikimi i politikanëve në çështjet operative të Policisë së Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	18
Grafiku 13: Niveli i përhapjes së korrupsionit në institucionet e Kosovës (2017)	19
Grafiku 14: Niveli i përhapjes së korrupsionit në institucionet e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	20
Grafiku 15: Niveli i përhapjes së korrupsionit në njësitet e Policisë së Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	22
Grafiku 16: Denoncimi i rasteve të korrupsionit në radhët e policisë (1) (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	23
Grafiku 17: Denoncimi i rasteve të korrupsionit në radhët e policisë (2) (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	24
Grafiku 18: Denoncimi i rasteve të korrupsionit në radhët e policisë (3) (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	25
Zbatimi i ndëshkimeve të rrepta për luftimin e korrupsionit në polici	25
Grafiku 19: Masat e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në Policinë e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	26
Grafiku 20: Institucionet që duhet të luftojnë korrupsionin në Policinë e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	27
Grafiku 21: Roli i OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)	28

PËR ANKETËN

Raundi i tretë i anketës së opinionit publik “Opinionit i qytetarëve për forcat e policisë” u zhvillua në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi. Pyetësi në bazë të të cilit u realizua anketa e opinionit publik u hartua nga rrjeti rajonal POINTPULSE në lidhje me mendimet e qytetarëve për policinë. Pyetësi kishte gjashtë grupe pyetjesh:

1. Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në institucione;
2. Perceptimi për policinë si institucion, por edhe për zyrtarët dhe zyrtaret e policisë si individë;
3. Perceptimi për korrupsionin në shoqëri dhe në forcat e policisë;
4. Opinioni i qytetarëve për luftën kundër korrupsionit;
5. Opinioni i qytetarëve për punën e organizatave të shoqërisë civile;
6. Të dhëna demografike.

Hulumtimi në terren në Kosovë u krye në korrik të vitit 2017 nga IPSOS Strategic Marketing, me një mostër përfaqësi prej 1,000 personash të moshës madhore në mesin e qytetarëve të Kosovës. Si instrument hulumtimi u përdor një pyetësor dhe intervistat u kryen duke përdorur teknikën “ballë për ballë”, e cila mundëson kontakt të drejtpërdrejtë me të anketuarit.

Raporti u botua si pjesë e projektit “Pulsi i Ballkanit Perëndimor për Integritetin dhe Besueshmërinë në Polici”, projekt që synon të kontribuojë në rritjen e besueshmërisë së policisë duke promovuar llogaridhënien dhe duke forcuar integritetin e policisë. Për këtë arsye, shtatë organizatat e shoqërisë civile nga rajoni u bënë bashkë për të krijuar rrjetin POINTPULSE: Analytica nga Shkupi, Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) nga Beogradi, Qendra për Studime të Sigurisë (CSS) nga Sarajeva, Instituti Alternativa (IA) nga Podgorica, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) nga Tirana dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nga Prishtina.

Projekti mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “Instrumenti i Shoqërisë Civile” në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

PËRMBLEDHJE

Policia është institucioni më i besueshëm në Kosovë gjatë vitit 2017. Trendët kanë nxjerrë në pah se besueshmëria e publikut në Policinë e Kosovës është rritur rreth 10 përqind më shumë në vitin 2017 në krahasim me vitet 2015 dhe 2016, duke e bërë kështu institucionin ndaj të cilit të anketuarit patën perceptimet më pozitive. Vlen të përmendet se anketa u realizua menjëherë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë, të cilat mund të kenë pasur ndikim tek rezultatet në lidhje me policinë.

Qëndrimet pozitive të të anketuarve ndaj policisë janë shfaqur në lidhje me perceptimet ndaj punonjësve të policisë, përfshirë këtu meshkuj dhe femra. Publiku i percepton zyrtarët dhe zyrtaret e policisë kryesisht si të sjellshëm, të kulturuar, të ndershëm dhe të besueshëm, të cilët punojnë duke respektuar ligjet dhe rregulloret e vendit.

Megjithatë, të anketuarit kanë shfaqur pikëpamje mjaft të ndryshme rreth procesit të përzgjedhjes dhe punësimit në radhët e policisë. Edhe pse shumica e të anketuarve besojnë se punësimi në polici bëhet nëpërmjet konkursit të hapur dhe publik, megjithatë ata i shohin lidhjet politike, lidhjet shoqërore e familjare dhe ryshfetin si çështje që duket se janë ende sfida të mëdha për një sistem të drejtë dhe meritore të procesit të rekrutimit.

Pavarësisht rezultateve që tregojnë se shumica e të anketuarve besojnë se Policia e Kosovës i shërben më së shumti qytetarëve, ekziston ende shqetësime serioz që policia i shërben interesave të Qeverisë dhe partive politike në Kosovë. Për më tepër, rreziku i ndikimit politik mbi policinë besohet të jetë shumë i lartë meqenëse se shumica e të anketuarve mendojnë se Policia e Kosovës është nën ndikimin e politikës, me theks të veçantë në punën operative të këtij institucioni.

Sipas perceptimeve të të intervistuarve, korrupsioni në institucionet e Kosovës është shumë i përhapur. Edhe pse korrupsioni në Policinë e Kosovës në vitin 2017 perceptohet se është më i ulët në krahasim me vitet e mëparshme, kjo nuk do të thotë se gjendja aktuale është e kënaqshme. Përveç kësaj, njësite të caktuara të policisë, si policia e trafikut, policia kufitare dhe bashkëpunëtorët më të afërt të ministrit të Punëve të Brendshme perceptohen si të korruptuara nga pothuajse 50 përqind e qytetarëve.

Për shkak të perceptimeve të publikut në Kosovë që shprehin shqetësime për nivelin e korrupsionit në njësi të caktuara të policisë, të anketuarit kanë dhënë mendimin e tyre për parandalimin e korrupsionit në polici. Më saktësisht, sipas këtij hulumtimi, dhënia e dënimeve të rrepta për shkelësit dhe më shumë dënime të ashpra për drejtuesit e policisë që përfshihen në korrupsion mund të jenë të domosdoshme në luftën kundër korrupsionit të policisë në Kosovë.

Si tregohet edhe nga trendët prej vitit 2015 deri në vitin 2017, të anketuarit kanë renditur Qeverinë në vendin e parë kur janë pyeten për institucionet që duhet të luftojnë korrupsionin brenda Policisë

së Kosovës. Më pas vijnë organet e kontrollit të brendshëm të policisë dhe Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK). Është e habitshme që vetëm një grup i vogël i të anketuarve (më pak se 5 përqind) e shohin Prokurorin e Shtetit si të rëndësishëm për të luftuar korrupsionin në polici. Kjo i atribuohet kryesisht nivelit të ulët të besueshmërisë së publikut tek prokuroria dhe gjykatat në përgjithësi. Edhe organizatat joqeveritare nuk shihen si një kontribuues i rëndësishëm në këtë drejtim.

Duke qenë se të anketuarit kanë shprehur shqetësime serioze se policia rrezikohet nga ndikimi i politikës në punën e saj operative, atëherë del se duhet të sigurohet pavarësia e Policisë së Kosovës dhe ajo të e lirë nga çfarëdo ndikimi. Në këtë drejtim, dispozitat e Ligjit për Policinë duhet të zbatohen plotësisht dhe nuk duhet të lejuar asnjë ndikim në punët operative të policisë.

Politikat e brendshme të Policisë së Kosovës duhet të forcohen më tej me qëllim që të garantohet se rekrutimi i kandidatëve për punësim në polici të bëhet sipas meritës. Inspektorati Policor i Kosovës duhet të inspektojë dhe mbikëqyrë rregullisht ciklet e rekrutimit në Policinë e Kosovës për të eliminuar dukuritë negative (si lidhjet politike, lidhjet shoqërore e familjare apo ryshfetet) në punësimin e personelit të ri policor.

Korrupsioni në Policinë e Kosovës është ende një shqetësim i madh. Prandaj, mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës duhet të fuqizojnë edhe më shumë aktivitetet për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin brenda institucionit. Sipas përgjigjeve që janë dhënë nga të anketuarit në këtë anketë, policia duhet të zbatojë ndëshkime të ashpra kur personeli i saj përfshihet në raste korrupsioni me qëllim të zvogëlimit dhe luftimit të korrupsionit në polici.

BESUESHMËRIA NË INSTITUCIONE

Policia është institucioni më i besueshëm në Kosovë

Në vitin 2017, Policia e Kosovës është renditur si institucioni më i besueshëm në Kosovë. Dy të tretat e të anketuarve (69 përqind) kanë besim te Policia e Kosovës, gjë që solli një rritje prej 10 përqind në krahasim me vitin 2016 (59 përqind). Policia e Kosovës ndiqet nga institucionet e arsimit, të cilat gëzojnë një nivel të qëndrueshëm të besueshmërisë nga 66 përqind e të anketuarve. Në krahasim me vitin e kaluar (2016), kur 66 përqind e të anketuarve i besonin institucioneve arsimore në Kosovë, gjatë vitit 2017 vihet re një rënie e vogël prej 1 përqind.

Sipas të dhënave të anketës, vendet e treta dhe të katërta janë zënë nga komunat dhe organizatat joqeveritare (OJQ) që veprojnë në Kosovë, ku 58 përqind e të anketuarve besojnë në punën e këtyre institucioneve. Në këtë drejtim, krahasuar me vitin 2016 vihet re një rritje prej 5 përqind (rreth 53 përqind për të dyja institucionet në vitin 2016). Krahas kësaj, mediat (56 përqind) dhe sektori i kujdesit shëndetësor (51 përqind) gëzojnë perceptim pozitiv nga të anketuarit në vitin 2016 dhe 2017, ndërsa rreth 47 përqind e të anketuarve u besojnë autoriteteve doganore.


Nga ana tjetër, Kuvendi i Kosovës ka dal si institucioni në të cilin të anketuarit kanë më së paku besim, përkatësisht 31 përqind e qytetarëve kanë mendim pozitiv për këtë institucion. Ngjashëm si edhe në vitin 2016, niveli i besueshmërisë në Kuvendin e Kosovës nuk është rritur ose përmirësuar në vitin 2017. Përkundrazi, sa i përket të dhënave statistikore, besueshmëria ka mbetur në të njëjtin nivel, ku 31 përqind e të anketuarve i besonin pushtetit legjislativ, ndërsa 67 përqind nuk i besonin gjatë vitit 2017.

Ndonëse institucionet gjyqësore dhe organet kundër korrupsionit në Kosovë gëzojnë nivel më të lartë të besueshmërisë sesa Kuvendi i Kosovës, megjithatë ekzistojnë shqetësime se këto institucione po përballen me sfida të mëdha duke pasur parasysh faktin se ato gëzojnë besimin e më pak se 45 përqind të të anketuarve. Në këtë drejtim, vetëm 40 përqind e të anketuarve besojnë tek gjyqësori dhe prokurorët. Nëse krahasohet me vitin 2016, vërehet se kjo është një rritje të lehtë, por niveli i mosbesimit tek të dyja këto institucione gjatë vitit 2017 është mjaft i lartë. Më saktësisht, 58 përqind e të anketuarve kanë perceptim negativ lidhur me gjyqësorin, ndërsa 56 përqind nuk kanë besim në punën e Prokurorisë së Kosovës.

Ndërkaq, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) gëzon besueshmërinë e 41 përqind të të anketuarve në vitin 2017, ndërsa rreth 56 përqind të tjerë kanë shprehur mendim negativ kur bëhej fjalë për punën e AKK-së. Megjithatë, perceptimi publik ndaj AKK-së ishte më negativ në vitin 2016, kur vetëm 38 përqind e të anketuarve ishin të kënaqur me punën e këtij institucioni. Nga ana tjetër, Inspektoratet e tregut gëzojnë pothuajse të njëjtin nivel të besueshmërisë (41 përqind).

Grafiku 1: Besueshmëria në institucionet e Kosovës (2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Sa keni besim tek institucionet e mëposhtme të Kosovës? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim, 2 nuk kam besim, 3 deri diku kam besim dhe 4 kam plotësisht besim.




Besueshmëria e publikut në Policinë e Kosovës për vitin 2017 konsiderohet se ka pasur një rritje të qëndrueshme në krahasim me vitet e mëparshme (2015 dhe 2016). Kjo është e rëndësishme të theksohet për shkak se Policia e Kosovës, ndër të tjera, është e ngarkuar të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës si dhe të ruajë rendin dhe sigurinë publike në vend. Prandaj, besueshmëria e qytetarëve në këtë institucion dëshmon se policia ushtron autorizimet e veta në përputhje me parimet ligjore dhe demokratike. Sidoqoftë, duhet të përmendet se anketa u realizua menjëherë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë, të mbajtura në qershor të vitit 2017, të cilat mund të kenë ndikuar deri në një shkallë të caktuar në perceptimin e qytetarëve për Policinë e Kosovës.

Siç shihet nga tabela e mëposhtme, derisa në vitin 2016 rreth 56 përqind e të anketuarve kishin besim në Policinë e Kosovës, në vitin 2016 kjo përqindje u rrit në 59 përqind. Megjithatë, krahasuar me dy vitet e mëparshme, matja e perceptimit të publikut të policisë ka treguar se besueshmëria e publikut gjatë vitit 2017 është rritur për 10 përqind, gjegjësisht rreth 69 përqind e të anketuarve kanë deklaruar se i besojnë Policisë së Kosovës.

Grafiku 2: Besueshmëria në Policinë e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)


Pyetje: Sa keni besim tek institucionet e mëposhtme të Kosovës? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim, 2 nuk kam besim, 3 deri diku kam besim dhe 4 kam plotësisht besim.



Nëse të dhënat e anketës në lidhje me policinë analizohen sipas perspektivës gjinore, atëherë bëhet e qartë se në vitin 2017 femrat në Kosovë i besojnë Policisë së Kosovës më shumë sesa meshkujt. Rrjedhimisht, 38 përqind e femrave kanë dhënë përgjigje pozitive në lidhje me Policinë e Kosovës krahasuar me 31 përqind të meshkujve që janë shprehur se i besojnë policisë. Megjithatë, mosbesimi tek policia është më i ulët tek meshkujt, më saktësisht 14 përqind e tyre nuk kanë aspak besim, ndërsa rreth 15 përqind e femrave kanë perceptime negative për Policinë e Kosovës gjatë vitit 2017. Nga ana tjetër, 1 përqind e të anketuarve ose edhe më pak prej tyre (femra dhe meshkuj së bashku) nuk kishin mendime ose nuk pranorin të jepnin përgjigje kur u pyetën për besueshmërinë në polici.

Grafiku 3: Perspektiva gjinore në perceptimin për Policinë e Kosovës (2017)

Pyetje: Sa keni besim tek institucionet e mëposhtme të Kosovës? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim, 2 nuk kam besim, 3 deri diku kam besim dhe 4 kam plotësisht besim.




Ashtu siç tregohet edhe në grafikun e mëposhtëm, rezultate pothuajse të ngjashme hasen sa i përket perceptimit për Policinë e Kosovës në zonat rurale dhe urbane të Kosovës. Rreth 39 përqind e të anketuarve nga zonat rurale deklaruan se i besonin policisë, ndërkohë që mendim pozitiv kishin vetëm 31 përqind e të anketuarve që jetonin në zonat urbane. Në të njëjtën kohë, përqindja e të anketuarve

në zonat rurale që nuk i besojnë policisë ishte 17 përqind krahasuar me 12 përqind të atyre që jetojnë në zonat urbane që kishin ndarë të njëjtin perceptim.

Grafiku 4: Perceptimi në zonat urbane dhe rurale për Policinë e Kosovës (2017)

Pyetje: Sa keni besim tek institucionet e mëposhtme të Kosovës? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim, 2 nuk kam besim, 3 deri diku kam besim dhe 4 kam plotësisht besim.




Analizimi i perceptimit të qytetarëve sipas perspektivës rajonale ofron të dhëna të detajuara në lidhje me besueshmërinë e publikut në Policinë e Kosovës. Të anketuarit nga rajoni i Prishtinës (pjesa qendrore e Kosovës) doli se kanë nivelin më të lartë të besueshmërisë në polici me rreth 25 përqind. Pas tyre janë të anketuarit nga rajoni i veri-perëndimit, ku 16 përqind prej tyre u përgjigjën pozitivisht sa i përket policisë. Nivel më të ulët të besueshmërisë u vu re tek të anketuarit në rajonin e jugperëndimit (11 përqind), veriut (10 përqind) dhe juglindjes (8 përqind).

Megjithatë, pjesa qendrore e Kosovës (rajoni i Prishtinës) është skeptike për shkak të supozimit se në krahasim me rajonet tjera është më tepër mosbesuese ndaj PK-së. Rrjedhimisht, rreth 11 përqind e të anketuarve që vijnë nga rajoni i Prishtinës nuk i besojnë policisë, ndërsa në rajone të tjera, si në juglindje, ashtu edhe në jugperëndim (6 përqind), në veri-perëndim (5 përqind) dhe në veri (2 përqind), njerëzit priren të jenë më pak dyshues ndaj Policisë së Kosovës.

Sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, popullsia me shumicë shqiptare në Kosovë mbizotëron me përqindje sa i përket perceptimit pozitiv për Policinë e Kosovës. Rreth 6 përqind e shqiptarëve të Kosovës i besojnë policisë, ndërsa rreth 24 përqind prej tyre nuk kanë besim te ky institucion. Pakicat etnike, veçanërisht serbët e Kosovës, duket se nuk i besojnë Policisë së Kosovës meqë vetëm 2 përqind e tyre kanë besim tek policia.


Grafiku 5: Perspektiva rajonale në perceptimin për Policinë e Kosovës (2017)

Pyetje: Sa keni besim tek institucionet e mëposhtme të Kosovës? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim, 2 nuk kam besim, 3 deri diku kam besim dhe 4 kam plotësisht besim.



Grafiku 6: Perspektiva etnike në perceptimin për Policinë e Kosovës (2017)

Pyetje: Sa keni besim tek institucionet e mëposhtme të Kosovës? Ju lutem përgjigjuni duke përdorur shkallën nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë që nuk kam aspak besim, 2 nuk kam besim, 3 deri diku kam besim dhe 4 kam plotësisht besim.



PERCEPTIMI PËR POLICINË


Perceptim pozitiv i publikut për policet dhe policët në Kosovë

Të anketuarit e kësaj ankete janë pyetur për perceptimin e tyre në lidhje me zyrtarët dhe zyrtaret e policisë në Kosovë. Këto perceptime janë kryesisht sipas kontaktit të drejtpërdrejtë të zyrtarëve dhe zyrtareve të policisë me qytetarët dhe kur bëhet fjalë për policet femra në Policinë e Kosovës, opinioni i publikut në Kosovë është kryesisht pozitiv.

Sipas përgjigjeve të qytetarëve, policet femra në Kosovë shihen si të sjellshme, të kulturuara dhe të përshtatshme nga 28 përqind e të anketuarve në këtë anketë. Ky rezultat u pasua nga 24 përqind e të anketuarve që besojnë se policet femra në Kosovë janë miqësore, të dobishme dhe komunikuese, rreth 18 përqind i konsiderojnë policet femra si të mira, të këndshme dhe interesante si dhe 14 përqind që i përshkruajnë ato si të drejta dhe që veprojnë duke respektuar ligjet dhe rregulloret. Megjithatë, vetëm 11 përqind e të anketuarve mendojnë se policet femra janë të arsimuara, rreth 7 përqind deklaruan se besojnë që ato janë të ndershme dhe nuk korruptohen, ndërkohë që vetëm 6 përqind e të anketuarve i përshkruajnë ato si të palodhura në punë.

Grafiku 7: Policia mesatare në Kosovë (2017)


Pyetje: Kur mendoni për policen femër, e cila është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa attribute (veti/fjalë), të cilat, sipas mendimit tuaj, do ta përshkruanin më së miri policen femër në Kosovë.



Nga ana tjetër, perceptimi i të anketuarve për policin tipik në Kosovë ndryshon paksa, por jo edhe aq shumë. Plot 27 përqind e të anketuarve i përshkruajnë policët meshkuj në Kosovë si të mirë, të këndshëm dhe interesant që përgjithësisht janë pozitive. Ky grup ndiqet nga 19 përqind e të anketuarve që i konsiderojnë policët meshkuj si të sjellshëm, të kulturuar dhe të përshtatshëm, ndërsa rreth 16 përqind prej tyre u përgjigjën se policët meshkuj janë të angazhuar për të mbrojtur qytetarët e Kosovës dhe punojnë në pajtim me ligjet dhe rregulloret. Megjithëse të anketuarit kanë tendencë për të dhënë mendime më tepër pozitive për policët meshkuj, prapëseprapë vetëm 9 përqind prej tyre i kanë përshkruar zyrtarët policorë si të ndershëm dhe që nuk korruptohen, 8 përqind që ata janë të edukuar dhe së fundmi 6 përqind janë përgjigjur se policët meshkuj janë të vrazhdë.

Grafiku 8: Polici mesatar në Kosovë (2017)

Pyetje: Kur mendoni për policin, i cili është në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, si do ta përshkruanit atë? Ju lutemi të theksoni disa attribute (veti/fjalë), të cilat, sipas mendimit tuaj, do ta përshkruanin më së miri policin në Kosovë.



Punësimi në polici ndikohet nga politika dhe nepotizmi

Kur janë pyetur për mënyrën e përzgjedhjes dhe rekrutimit të kandidatëve për punësim në Policinë e Kosovës, të anketuarit kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Duke qenë se ky proces konsiderohet si një nga fazat më të hershme të integritetit të policisë, të anketuarit kanë pas mundësi për të dhënë më shumë se një përgjigje në këtë pyetje. Për shkak të faktit se rekrutimi në polici është i hapur për publikun, pjesa më e madhe e të anketuarve në Kosovë nga viti 2015 deri më 2017 kanë renditur në vendin e parë konkursin publik për bëhet fjalë për procesin e rekrutimit. Rreth 63 përqind e të anketuarve kishin të njëjtin mendim, gjë që në krahasim me vitin 2016 (54 përqind) dhe vitin 2015 (53 përqind), më 2017 kishte një rritje prej afro 10 përqind.


Sidoqoftë, në sytë e të anketuarve, procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për rekrutim në kuadër të Policisë së Kosovës nuk është krejtësisht pozitive. Kjo për shkak se rreth 44 përqind e të anketuarve mendojnë se punësimi në polici bëhet përmes lidhjeve shoqërore dhe/ose familjare, duke pranuar kështu ekzistencën e disa aspekteve të padrejta lidhur me rekrutimin në Policinë e Kosovës. Mendime të tilla qytetarët kishin ndarë edhe në vitet e mëparshme, gjegjësisht në vitin 2015 (44 përqind) dhe më 2016 (41 përqind).

Është e rëndësishme të theksohet se lidhjet politike ende konsiderohen si një rrezik potencial kur bëhet fjalë për rekrutimin në polici. Trendët e tre viteve të fundit (2015-2017) tregojnë se në vitin 2015 ishte arritur shkalla më e lartë prej 39 përqind të qytetarëve që ishin deklaruar se përzgjedhja e kandidatëve për punësim në polici bëhet nëpërmjet lidhjeve politike. Kjo përqindje kishte rënë në 24 përqind në vitin 2016, por në vitin 2017 përqindja u rrit përsëri duke arritur në nivelin prej 36 përqind. Prandaj, mund të thuhet se procesi i rekrutimit në polici ndikohet nga politika.

Përveç kësaj, edhe ryshfeti besohet të ketë ndikim negativ në këtë proces, ndonëse siç tregojnë rezultatet e tri viteve të fundit, kjo mënyrë për gjetjen e një vendi të punës në polici është në zvogëlim e sipër.

Grafiku 9: Mënyrat e përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në Policinë e Kosovës (përgjigje të shumëfishta – krahasimet ndërmjet viteve 2015, 2016 dhe 2017)

Pyetje: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mënyre bëhet përzgjedhja e kandidateve për punësim në polici?



Policia e Kosovës i shërben më së shumti interesave të qytetarëve


Perceptim pozitiv për Policinë e Kosovës u vu re edhe kur të anketuarve iu bë pyetja se në interesin e kujt vepron më së shumti policia. Në këtë drejtim, rreth dy të tretat e të anketuarve në vitin 2017 (ose 66 përqind) besonin se Policia e Kosovës i shërben më së shumti qytetarëve, gjë që tregon një rritje prej pothuajse 10 përqind kur rezultatet krahasohen me ato të vitit 2016 (54 përqind) dhe 2015 (53 përqind).

Megjithatë, pjesa tjetër e qytetarëve kanë shprehur mendimin se Policia e Kosovës punon në interes të palëve të caktuara të jashtme, të cilat mund të dëmtojnë integritetin e policisë në Kosovë. Rrjedhimisht, gati 20 përqind e të anketuarve besojnë se Policia e Kosovës vepron për të mbrojtur interesat e Qeverisë së Kosovës. Edhe pse ky numër ka pësuar një rënie të lehtë në krahasim me përqindjen e arritur në vitin 2015 (22 përqind) dhe 2016 (23 përqind), ende ekzistojnë shqetësime se disa komponentë brenda Policisë së Kosovës punojnë për interesat e Qeverisë.

Pavarësisht faktit se në vitin 2017 rezultatet treguan se 10 përqind e të anketuarve besonin se Policia e Kosovës mbron interesat e partive politike në Kosovë, ka ende një rënie të dukshme krahasuar me vitet e mëparshme, siç tregohet nga të dhënat që jepen në grafikun e mëposhtëm. Rreth 5 përqind e të anketuarve deklaruan se Policia e Kosovës mbron interesat e zyrtarëve që janë në hierarkinë e lartë të policisë. Sipas përgjigjeve të të anketuarve, mund të arrihet në përfundimin e përgjithshëm se Policia e Kosovës po përmirësohet kur është fjala për t'i shërbyer qytetarëve dhe publikut të Kosovës.

Grafiku 10: Kapaciteti në të cilën Policia e Kosovës vepron më së shumti (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)


Pyetje: Në çfarë kapaciteti Policia e Kosovës vepron më së shumti?



Kur të anketuarit janë pyetur se në interes të kujt Policia e Kosovës vepron më së paku, ata renditën fillimisht interesat e partive politike (35 përqind), ndërkohë që interesat e Qeverisë dhe të qytetarëve kishin të njëjtën përqindje (24 përqind). Së fundi, rreth 17 përqind e të anketuarve u përgjigjën se Policia e Kosovës vepron më së paku për të mbrojtur interesat e zyrtarëve në hierarkinë e lartë të policisë.

Grafiku 11: Kapaciteti në të cilën Policia e Kosovës vepron më së paku (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Në çfarë kapaciteti Policia e Kosovës vepron më së paku?



Nivel i lartë i ndikimit të politikanëve në Policinë e Kosovës


Edhe pse Policia e Kosovës gëzon një shkallë të lartë të besueshmërisë nga të anketuarit dhe shumica e tyre kanë thënë se policia vepron kryesisht në shërbim të qytetarëve, megjithatë rreziku i ndikimit politik në polici konsiderohet ende relativisht i lartë. Prandaj, shumica dërrmuese e të anketuarve në vitin 2017 mendojnë se Policia e Kosovës është me të vërtetë nën ndikimin politik, me theks të veçantë në punës operative të këtij institucioni, gjë që normalisht do të duhej të jetë e ndarë nga vendimmarrja politike.

Për më tepër, rreth 87 përqind e të anketuarve besonin se në vitin 2017 Policia e Kosovës ishte ekspozuar ndaj ndikimit politik në një shkallë të caktuar. Më saktësisht, rreth 14 përqind prej tyre kanë shprehur pikëpamjen se çështjet operative të policisë ishte plotësisht të ndikuara nga politikanët, ndërsa rreth 42 përqind mendonin se shkalla e ndikimit politik ishte mjaft e lartë. Rreth 31 përqind e të anketuarve mendonin se ndikimi i politikanëve në polici ekziston në një nivel të caktuar, por në një masë më të vogël. Nga ana tjetër, ky hulumtim ka vënë në dukje se vetëm 7 përqind e të anketuarve besonin se nuk kishte ndikim politik në polici gjatë vitit 2017.

Siç tregon edhe grafiku në vijim, rezultatet më negative u regjistruan në vitin 2015, kur rreth 91 përqind e numrit të përgjithshëm të të anketuarve besonin se politikanët ushtronin ndikim mbi procesin e vendimmarrjes së policisë në lidhje me çështjet operative të policisë. Në vitin 2016 ajo kishte rënë për 5 përqind më pak (86 përqind gjithsejtë). Megjithatë, në vitin 2017 përqindja u rrit me një përqind më shumë në krahasim me të dhënat e anketës së vitit 2016.

Grafiku 12: Ndikimi i politikanëve në çështjet operative të Policisë së Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase politikanët kanë ndikim në çështjet operative të policisë?



PERCEPTIMI PËR KORRUPSIONIN

Kosova dhe institucionet e saj janë ende duke u përballur me korrupsionin si sfidë kryesore që pengon reformat e nevojshme në vend dhe ndërtimin e masave afatgjata të integritetit në nivel institucional. Prandaj, kjo anketë synon të zbërthejë perceptimet e publikut në Kosovë lidhur me korrupsionin brenda institucioneve, veçanërisht në polici.


Kuvendi i Kosovës është institucioni më i korruptuar më 2017


Pavarësisht rezultateve pozitive të disa institucioneve që duket se gëzojnë besueshmëri në shkallë të lartë nga të anketuarit, sidoqoftë institucionet e Kosovës ende vuajnë nga perceptimi i përhapjes së madhe të korrupsionit. Duke u mbështetur në rezultatet e anketës së vitit 2017, Kuvendi i Kosovës është institucioni më i korruptuar në Kosovë sipas mendimit të 61 përqind të të anketuarve që besojnë se korrupsioni është përhapur në shkallën më të lartë ose në një shkallë të caktuar në këtë institucion. Vendin e dytë dhe të tretë, sipas të anketuarve, e kanë zënë institucionet shëndetësore dhe gjyqësore meqë rreth 60 përqind e të anketuarve janë shprehur se të dyja këto institucione janë të korruptuara. Ato ndiqen nga Prokuroria (55 përqind), doganat (53 përqind) dhe inspektoratet e tregut (52 përqind). Të gjitha këto institucione perceptohen se janë të prekura nga niveli më i lartë i korrupsionit.

Nga ana tjetër, institucionet më pak të korruptuara sesa ato të përmendura më lart janë mediat dhe institucionet arsimore që janë perceptuar si më pak të korruptuara nga 46 përqind e të anketuarve, së bashku me komunat dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, të cilët ndajnë të njëjtën përqindje prej 41 gjithsejtë. Më pak të korruptuara, sipas të anketuarve, janë policia (40 përqind) dhe organizatat jo-qeveritare (34 përqind).

Grafiku 13: Niveli i përhapjes së korrupsionit në institucionet e Kosovës (2017)

Pyetje: Në çfarë mase është i përhapur korrupsioni në institucionet e mëposhtme?







Kur analizohen të dhënat e anketave të tre viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017) duke përdorur një qasje krahasuese, atëherë del një pamje më e qartë e perceptimit të qytetarëve lidhur me praninë e korrupsionit në institucionet e Kosovës. Rreziku i korrupsionit në Kuvendin e Kosovës, institucionet shëndetësore, organet gjyqësore, dogana, inspektoratet e tregut, mediat dhe institucionet arsimore ka mbetur pothuajse në të njëjtat nivele të larta, siç tregohet në grafikun e mëposhtëm.

Ndërkohë, perceptimi i korrupsionit në Prokurori ka rënë në 8 përqind më pak gjatë periudhës 2016 deri në vitin 2017, kurse ky perceptim në Agjencinë Kundër Korrupsionit është zvogëluar për 6 përqind, gjegjësisht nga 47 përqind që ishte në vitin 2016 në 41 përqind në vitin 2017. Për sa i përket Policisë së Kosovës, trendët tregojnë se në vitin 2015 ishte niveli më i lartë i korrupsionit prej nga 53 përqind gjithsejtë. Në 2016, korrupsioni policor pësoi një rënie të ndjeshme në 42 përqind, ndërsa në vitin 2017 kishte rënë për 2 përqind më pak (40 përqind gjithsejtë). Ndërsa, OJQ-të që veprojnë në Kosovë kanë dal si organet më pak të korruptuara gjatë periudhës së fundit trevjeçare.

Grafiku 14: Niveli i përhapjes së korrupsionit në institucionet e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Në çfarë mase është i përhapur korrupsioni në institucionet e mëposhtme?





Policia e trafikut dhe policia kufitare janë më të prekurat nga korrupsioni


Në këtë hulumtim të anketuarit janë pyetur edhe për perceptimin e tyre në lidhje me nivelin e rrezikut të korrupsionit në radhët e njësiteve policore në Kosovë. Kështu, policia e trafikut në Policinë e Kosovës përfundoi në krye të listës si njësi më i korruptuar i policisë me 49 përqind të të anketuarve që kanë shprehur këtë mendim. Trendët kanë vënë në dukje se ky perceptim negativ për këtë njësi është ulur në këtë periudhë për 1 përqind kur rezultatet krahasohen me ato të vitit 2016 (50 përqind). Edhe në vitin 2015, perceptimi i korrupsionit në policinë rrugore ishte më i lartë se më 2016 (53 përqind).

Ndërsa, policia kufitare konsiderohet si njësi i dytë më i korruptuar në kuadër të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2017, gjegjësisht 47 përqind e të anketuarve e kanë shprehur këtë si shqetësim. Megjithatë, perceptimi i korrupsionit në këtë njësi është rritur në krahasim me vitet e kaluara. Për më tepër, në vitin 2016 policia kufitare u rendit si njësi e korruptuar nga 44 përqind e të anketuarve, ndërsa në vitin 2015 ishte 7 përqind më e lartë se ajo e vitit 2017 dhe 10 përqind më e lartë se ajo e vitit 2016, më saktësisht 54 përqind gjithsejtë.

Nga ana tjetër, bashkëpunëtorët më të afërt të ministrit të Punëve të Brendshme u konsideruan të korruptuar nga 46 përqind e të anketuarve në vitin 2017, me një rënie prej 2 përqind kur bëhet krahasimi me rezultatet e vitit 2016 (48 përqind). Njësitë e policisë që perceptohen si më pak të korruptuara janë policia kriminale dhe policia që merret me rendin publik, për të cilat 35 përqind e qytetarëve besojnë se janë të prekura nga korrupsioni. Së fundmi, sipas opinionit të qytetarëve, njësitet më së paku të korruptuara të Policisë së Kosovës janë administrata e policisë (31 përqind) dhe forcat speciale të policisë (31 përqind).

Grafiku 15: Niveli i përhapjes së korrupsionit në njësitet e Policisë së Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Në çfarë mase është i përhapur korrupsioni në njësitet e mëposhtme të policisë?



LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT


Shumica e qytetarëve janë të gatshëm të denoncojnë korrupsionin policor

Beteja kundër korrupsionit policor në Kosovë shtrun nevojën që edhe qytetarët të bashkëpunojnë me policinë: ata duhet të raportojnë rastet e korrupsionit sa herë që ndodhin raste të tilla. Në këtë drejtim, të anketuarit janë pyetur nëse ishin të gatshëm të raportonin rastet e korrupsionit policor. Vlen të përmendet se në vitin 2017 pothuajse 60 përqind e të anketuarve kanë shprehur gatishmërinë për të raportuar raste korrupsioni në Policinë e Kosovës, edhe pse atyre do t'u duhej të tregonin të dhënat personale, si numri i identifikimit personal, adresa etj. Gjithashtu, kjo përputhet me nivelin e lartë të besimit që të anketuarit kanë tek policia. Megjithatë, rreth 35 përqind prej tyre nuk janë të gatshëm të denoncojnë raste të korrupsionit policor në Policinë e Kosovës.

Për më tepër, kur rezultatet e vitit 2017 krahasohen me ato të viteve të mëparshme, këto rezultate janë më pozitive, duke pasur parasysh faktin se është vërejtur rritje prej 8 përqind në krahasim me vitin 2016 dhe rritje prej 6 përqind me vitin 2015 të atyre që ndjeheshin të sigurt për të denoncuar rastet e korrupsionit të policisë në Policinë e Kosovës edhe nëse u kërkohet të zbulojnë informatat e tyre personale. Kjo tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve besojnë se policia nuk do të keqpërdorë të dhënat e tyre personale dhe se bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet qytetarëve dhe policisë është i mundur.

Grafiku 16: Denoncimi i rasteve të korrupsionit në radhët e policisë (1) (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: A do ta denonconit raste të korrupsionit në polici (nëse ju kërkon dikush ryshfet) nëse ju duhet që të zbuloni të dhënat personale (numrin personal, adresës etj.)?




Në këtë anketë të anketuarit janë pyetur po ashtu nëse do të denonconin raste korrupsioni të policisë tek Policia e Kosovës, nëse nuk do t'u kërkohet të zbulonin të dhënat personale. Në këtë rast, numri i të anketuarve të gatshëm për të raportuar raste të tilla në polici ishte më i ulët, në krahasim me të dhënat e mësipërme. Vetëm 44 përqind e të anketuarve do të raportonin një rast të tillë, në krahasim me 50

përqind të tjerë që nuk do të denonconin. Për më tepër, në vitin 2016 (35 përqind) dhe më 2015 (32 përqind) këto përqindje ishin edhe më të ulëta në krahasim me të dhënat e vitit 2017.

Grafiku 17: Denoncimi i rasteve të korrupsionit në radhët e policisë (2) (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: A do ta denonconit raste të korrupsionit në polici nëse nuk ju kërkohet të zbuloni të dhënat personale?



Stacioni lokal i policisë – adresa e parë ku qytetarët do të denonconin korrupsionin policor në Kosovë


Krahas denoncimit të rasteve të mundshme të korrupsionit policor në Policinë e Kosovës, të anketuarit janë pyetur se kujt do t'i drejtoheshin për të raportuar raste të tilla të korrupsionit brenda dhe jashtë policisë.

Ashtu si në dy vitet e mëparshme, edhe në vitin 2017 të anketuarit renditën stacionet lokale të policisë si vendin e parë ku ata do të denonconin raste të korrupsionit në polici. Shumica e tyre, përkatësisht 72 përqind do të denonconin një rast të tillë së pari në stacionin lokal të policisë, më pas te komandanti i stacionit të policisë (43 përqind) dhe organet e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës (40 përqind). Në këtë mënyrë, tre rastet e para të zgjedhura nga të anketuarit për të denoncuar rastet e korrupsionit policor i përkisnin njësisive të policisë. Institucionet e tjera, të tilla si AKK –ja (38 përqind), mediat (31 përqind), mikut që punon në polici (17 përqind) dhe OJQ-të (11 përqind) kishin përqindje më të vogla sipas të anketuarve.

Është e befasishme që AKK-ja, e cila në vitin 2016 dhe 2015 u evidentua si institucioni i dytë (pas stacionit lokal policor) për të denoncuar raste të korrupsionit në polici, ka kaluar në vendin e katërt gjatë vitit 2017. Nga ana tjetër, OJQ-të nuk perceptohen ende pozitivisht nga të anketuarit si organe me të cilat të bashkëpunohet për këtë çështje, pasi vetëm një grup i vogël i të anketuarve i renditi ato si adresa për denoncimin e korrupsionit policor.

Grafiku 18: Denoncimi i rasteve të korrupsionit në radhët e policisë (3) (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Cilit nga lista e mëposhtme do t'i raportoni të parit rastin e korrupsionit në polici? Kujt tjetër?



Zbatimi i ndëshkimeve të rrepta për luftimin e korrupsionit në polici

Fuqizimi i rregullave dhe politikave të brendshme në Policinë e Kosovës perceptohet nga të anketuarit si kontribut i domosdoshëm për parandalimin e korrupsionit në Policinë e Kosovës. Rrjedhimisht, rreth 18 përqind e të anketuarve deklaruan se duhet të ketë ndëshkime të ashpra për shkelësit dhe se duhet të zbatohen më shumë ndëshkime ndaj drejtuesve të policisë të përfshirë në korrupsion si mënyra për parandalimin e korrupsionit në polici. Kjo nënkupton nevojën për të përmirësuar masat e integritetit me qëllim dhënien e ndëshkimeve më të ashpra për zyrtarët policorë që mund të dëmtojnë integritetin e policisë. Krahas kësaj, afro 14 përqind e të anketuarve kanë konstatuar se qytetarët e Kosovës duhet të motivohen ose të inkurajohen që të denoncojnë policët e korrumpuar, ndërsa një grup tjetër prej 12 përqind kanë kërkuar fuqizimin e organeve të kontrollit të brendshëm policor.

Masat tjera të përmendura nga të anketuarit kanë qenë rritja e rrogave të zyrtarëve policorë (10 përqind), vullneti politik i Ministrit të Punëve të Brendshme dhe i drejtuesve të lartë të policisë për zgjidhjen e problemeve (10 përqind), nevojën për të krijuar një agjenci të re për parandalimin e korrupsionit të policisë (6 përqind) dhe më shumë përpjekje për të nxitur punonjësit e policisë që të denoncojnë kolegët e tyre të përfshirë në korrupsion (6 përqind).

Grafiku 19: Masat e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në Policinë e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Çfarë është më e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit në polici?




Qeveria e Kosovës duhet të luftojë korrupsionin në polici

Të anketuarve u është kërkuar të rendisin institucionet të cilat, sipas tyre, duhet të luftojnë korrupsionin në Policinë e Kosovës. sipas përgjigjeve të dhëna në anketë, duket se të intervistuarit nuk janë të informuar mirë se cilat institucione kanë për detyrë të luftojnë korrupsionin, me theks të vecantë korrupsionin në polici. Sikurse në vitet 2015 dhe 2016, edhe në vitin 2017, rreth 25 përqind e të anketuarve përsëri e kanë renditur Qeverinë e Kosovës si institucionin e parë që duhet të luftojë korrupsionin në polici. Pas kësaj, vijnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës (14 përqind), AKK-ja (12 përqind), zyrtarët policët (10 përqind), Drejtori i Policisë (9 përqind), ministri i Punëve të Brendshme (8 përqind) dhe bashkësia ndërkombëtare (6 përqind).

Është interesante që vetëm 4 përqind e të anketuarve besojnë se Prokuroria duhet të luftojë rastet e korrupsionit të policisë. Në përgjithësi, kjo lidhet me nivelin e ulët të besueshmërisë të të anketuarve tek prokurorët dhe gjykatat në Kosovë. Institucionet e tjera, si Sindikata e Policisë së Kosovës (3 përqind), Kuvendi i Kosovës (2 përqind) dhe OJQ-të (1 përqind) kishin përqindje edhe më të ulëta në luftën kundër korrupsionit në polici. Siç tregohet në grafikun e mëposhtëm, të njëjtat rezultate vihen re edhe në vitet e mëparshme, më 2015 dhe 2016, ndonëse me disa dallime të vogla.

Grafiku 20: Institucionet që duhet të luftojnë korrupsionin në Policinë e Kosovës (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Shikoni listën e mëposhtme të institucioneve dhe tregoni se cili institucion duhet të jetë para të gjithë të tjerëve për luftimin e korrupsionit në polici.



Nevoja për rritjen e rolit të OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit


Kjo anketë ka treguar se të anketuarit nuk e shohin rolin e OJQ-ve në Kosovë si të rëndësishëm, ndonëse ata presin që OJQ-të të marrin një rol edhe më të madh në luftën kundër korrupsionit dhe të shërbejnë si vëzhgues për sundimin e ligjit në vend.

Prandaj, rreth 28 përqind e të anketuarve kanë perceptimin se OJQ-të duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në luftën kundër korrupsionit, krahasuar me 24 përqind të atyre që besojnë se OJQ-të duhet të bashkëpunojnë me institucionet shtetërore për të luftuar korrupsionin. Publiku në Kosovë pret nga OJQ-të që të japin kontribut me ekspertizën e tyre, përkatësisht 24 përqind e të anketuarve kërkuan që organizatat e shoqërisë civile të japin rekomandime në lidhje me luftën kundër korrupsionit.

Nga ana tjetër, OJQ-të shihen si instrument për të ndihmuar viktimat e korrupsionit (8 përqind) si dhe për të promovuar aktivitetet dhe punën e ndershme në institucionet publike (7 përqind), gjë që gjithashtu lidhet me integritetin.

Grafiku 21: Roli i OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit (2015, 2016 dhe 2017 - krahasim)

Pyetje: Qytetarët kanë mendime të ndryshme në lidhje me rolin e OJQ-ve në luftën kundër korrupsionit. Duke pasur këtë parasysh, cili mendoni se do të duhej të jetë roli i tyre në luftën kundër korrupsionit?



METODOLOGJIA

Vendi	Kosovë
Koha	Korrik 2017
Metoda e mbledhjes së të dhënave	Intervista ballë për ballë, në vendbanimet e të intervistuarve
Mostra	Qytetarë dhe qytetare të Kosovës të moshës mbi 18 vjeç, të cilët janë me banim të përhershëm në territorin e Kosovës në kohën e realizimit të kësaj ankete.
Madhësia e mostrës	1,000
Lloji i mostrës	Mostra me shtresëzim përfaqësimi rastësor me tre faza
Shtresëzimi	Anketa është realizuar sipas rajoneve, llojit të vendbanimit, gjinisë, moshës dhe nivelit të arsimit
Marzha e gabimit	±3.31 përqind

POINTPULSE

WESTERN BALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST



WWW.POINTPULSE.NET



twitter.com/POINTPULSEnet



facebook.com/POINTPULSEnet/

Civil society network dedicated to oversight of police integrity.